

# "Roli i Agjencisë kundër Korrupsionit në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë"

**Kandidate:** Egzona Shala

**Mentori:** Prof. Ass. Dr. Flutura Tahiraj

Një ndër arsyet pse një vend është i varfër ekonomikisht është pikërisht korrupsioni si indikator kyç. Kjo dukuri negative që është pjesë e çdo shoqërie bashkëkohore por mjaft e pranishme edhe tek ne, ka kapluar edhe institucionet më të rëndësishme të një vendi. Andaj duhet të ekzistojë përpjekja për të përmirësuar politikën, strategjitë, institucionet, ligjet dhe çdo gjë tjetër që ndërlikohet me pengimin e këtij fenomeni.

Çdo vend ka edhe mekanizmat që luftojnë apo që përballen me këtë dukuri negative. Tek ne dallojmë disa mekanizma ku ndër to është edhe Agjencia Kundër Korrupsionit, e cila ka për mision të vetin të raportojë për rastet e shkeljeve, keqpërdorimeve të detyrës zyrtare, e që nga raportet vjetore të raportuara nga kjo Agjenci tregohet se pothuajse të gjitha institucionet si ato të nivelit qendror ashtu edhe ato të nivelit lokal, janë të përfshira në raste të dyshimta korruptive.

Ajo që është për tu ardhur keq është fakti që përveç se ky fenomen ka kapluar të gjitha hallkat e organeve shtetërore, korrupsionin çdo ditë e më shumë e hasim edhe në përditshmëri nga njeriu i thjeshtë, andaj është një situatë mjaft shqetësuese për një shoqëri si kjo e jona, ku në bazë të statistikave vendi ynë po del të jetë një prej vendeve me përqindjen më të lartë të korrupsionit në rajon.

Pa dyshim që korrupsioni si i tillë nuk është diçka që mund të parandalohet dhe luftohet brenda natës, apo për një periudhë të shkurtër, por kërkon një proces të gjatë dhe një selektim të mekanizmave të duhur në luftën kundër kësaj dukurie të dëmshme për shoqërinë dhe ekonominë e këtij vendi.

Andaj edhe kam zgjedhur që të hulumtojë më tepër rreth mekanizmave më saktësisht rreth rolit të Agjencisë kundër korrupsionit në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe përballjes konsekuente me këtë fenomen aq negativ për shoqërinë.

Objektivi kryesor i këtij punimi është pra roli që kanë mekanizmat në ballafaqimin me këtë dukuri, si dhe pasqyrimi i gjendjes reale të veprave korruptive, duke përfshirë edhe sfidat në të cilat kalon

Shteti i Kosovës sa i përket luftimit të këtij fenomeni mjaft të përfulur në mbarë botën. Ky punim analizon Institucionet kompetente për luftimin e korrupsionit, përkatësisht rolin e AKK-së në luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni.

Gjithashtu qëllimi i këtij punimi është të kontribuojë në literaturë duke mundësuar një model teorik dhe praktik mbi rolin e AKK-së në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë si dhe me sfidat e luftimit të tij në vendin tonë. Ky punim gjithashtu do të sjell një element të rëndësishëm përmes statistikave të veprave të korrupsionit, numri i rasteve të paraqitura deri tek numri i rasteve të dënuara.

**Fjalët kyçe:** Korrupsioni, Agjencia kundër korrupsionit, Legjislacion penal, Sfidat.